



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 5 datë 23.01. 2026

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KULTUROR DHE ARGËTUES PËR VITIN 2026
DHE AKORDIMIN E FONDIT PËRKATËS**

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e këshillave artistiko-kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre”, të ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 24.05.2005 të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko-kulturor”, si dhe bazuar në relacionin e Drejtorisë së Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë programin kulturor dhe artistik për vitin 2026, si më poshtë:

- Festa e 7–8 Marsit – 130,000 lekë
- Dita e Verës (14 Mars) – 170,000 lekë
- Në Gjurmët Naimiane – 100,000 lekë
- Festojnë Fëmijët (1 Qershor) – 80,000 lekë
- Të Premtet Muzikore (Korrik) – 120,000 lekë
- Muaji i Letërsisë dhe Artit – 20,000 lekë
- Festojmë së Bashku Festat e Fundvitit – 100,000 lekë

2. Të miratojë kryerjen e shpenzimeve për realizimin e aktiviteteve të mësipërme në vlerën totale 720,000 (shtatëqind e njëzet mijë) lekë, që do të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Përmet për vitin 2026.

3. Ngarkohet Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Anila DHIMITRI

